



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 78 Prot.

Tiranë, më 17. 01. 2019

V E N D I M

Nr. 8, Datë 17. 01. 2019

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 122, datë 14.08.2018, e shtetasve A. Y., A. Sh. dhe K. Y., kundër Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime sh.a. Fier, në të cilën pretendohet diskriminim *për shkak të racës, etnisë dhe gjendjes ekonomike*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesit e mësipërm janë banorë të lagjjes Mbrostar të Bashkisë Fier. Sipas tyre, kjo lage nuk furnizohet me ujë të pijshëm nga ana e Drejtorisë së Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a. (në vijim UKF sh.a.). Prej 5-6 vitesh i janë drejtuar disa herë Bashkisë Fier dhe UKF sh.a., por nga ana e tyre nuk është marrë asnjë masë përfurnizimin me ujë të pijshëm të kësaj lagje. Në kushtet e mungesës së furnizimit me ujë të pijshëm, disa prej banorëve kanë gjetur zgjidhje alternative, hapjen e puseve në mënyrë private. Duke qënë se kjo zonë është e populluar kryesisht me anëtarë të komunitetit rom dhe nuk janë në gjendje të mirë ekonomike, nuk kanë patur mundësi të sigurojnë ujë të pijshëm nëpërmjet shpimit të puseve.

Përsa më lart, ankuesit janë ndier të trajtuar në mënyrë pafavorshme dhe diskriminuese nga ana e Bashkisë Fier dhe UKF-së, pasi nga ana e tyre nuk është marrë asnjë masë përfurnizimin me ujë të pijshëm. Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

ankuesit kanë kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese për shkak të racës, etnisë dhe gjendjes ekonomike, si dhe t'i rekomandojë Bashkiës Fier dhe UKF-së, të marrin masa për furnizimin me ujë të pijshëm të kësaj zone.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Neni 7 i LMD-së¹, në pikën 1 të tij, parashikon se: “*Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupei personash, ose që i eksponoz ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjtë apo të ngashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim*”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkosat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsy, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloj procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës Nr. 1124/1 prot., datë 16.08.2018, kërkoi informacion² lidhur me pretendimet e ankuesve nga ana e Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Fier.

¹ Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

² - Informacion mbi pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e shtetasve A. Y., A. Sh. dhe K. Y.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Fier, me anë të të shkresës Nr. 790/1 prot., datë 27.08.2018, informoi KMD-në se: "... *realizon furnizimin me ujë në këtë komunitet në unison me abonetët e tjerë në zonën tonë të shërbimit. Aktualisht në këtë komunitet për 5 vitet e fundit janë realizuar këto investime: Në Levan rrëth 150 mijë euro me buxhetin e KWF; Në Mbrostar-Ura rrëth 1,8 milion lekë duke ndërtuar një pus/çpim të ri dhe shpërndarë ujin në këtë lagje dhe në 5 çesma publike; Në fshatin Baltëz rrëth 500 mijë lekë duke rehabilituar stacionin e pompave dhe një pjesë të rrjetit shpërndarës; Në qytetin e Fierit rrëth 150 mijë lekë duke rehabilituar rrjetin perëndimor të lagjes rome Drizë. Problematika për këtë komunitet janë: Kryesisht nuk bëhen abonent në kompaninë tonë, nuk realizojnë pagesat mujore konform Kodit të Ujit dhe shpërdorime masive të ujit kryesisht në zonën Levan, duke krijuar edhe probleme me banorët e tjerë të zonës. Ankimeshit u verifikuan dhe rezulton që nuk janë abonent dhe furnizimi me ujë bëhet me anë të çesmave publike në zonë. Në këtë kuadër, kompania jonë do të realizojë një program sensibilizues në këtë komunitet dhe do të krijojë të gjitha mundësitë që furnizimi me ujë i këtij komuniteti të bëhet konform normave në fuqi.*"

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar të KMD-së, nga ana e Bashkisë Fier nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion.

2. Referuar informacionit të dhënë nga Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Fier dhe mungesa e përgjigjes nga Bashkia Fier, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi të realizojë një seancë dëgjimore mes palëve. Për këtë me anë të shkresës Nr. 1124/3 prot., datë 05.10.2018, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 10.10.2018, ora 12:00.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 10.10.2018, ishte prezent vetëm përfaqësuesi i ankuesve³. Ndrësa nga ana e Bashkisë Fier dhe UKF-së, pavarësisht se ishin vënë në dijeni⁴ lidhur me shkresën Nr. 1124/3 prot., datë 05.10.2018, nuk ishin prezent në seancën dëgjimore.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesi u vu në dijeni të shkresës Nr. 790/1 prot., datë 27.08.2018, të UKF-së dhe sqaroi se: "...*mund të jenë realizuar investimet e cituara në shkresën e UKF-së, por realisht prej vitesh familjet e komunitetit rom dhe egjiptian që banojnë në lagjen Mbrostar, nuk furnizohen me ujë të pijshëm.*" Gjithashtu, sqaroi se në dijeninë e tij, në këtë zonë nuk ekzistonte një rrjet i ujësjellës kanalizimeve dhe për këtë shkak këto familje nuk furnizoheshin nga ana e Bashkisë Fier dhe UKF-së me ujë të pijshëm. Në përfundim, përfaqësuesi i ankuesve

-
- Informacion nëse janë kryer ndonjëherë investime përfundim me ujë të pijshëm në lagjen Mbrostar. Nëse po, kopje të dokumentacionit provues.
 - Informacion, nëse banorët e lagjes Mbrostar, i janë drejtuar ndonjëherë Bashkisë Fier dhe UKF-së, lidhur me mungesën e ujit të pijshëm. Nëse po, kopje të tyre.

³ Shtetas G. S.

⁴ Refruar Lajmërim Marrjes së Postës Shqiptare, subjektit kanë marrë dijeni më datë 08.10.2018

shtoi se, pavarësisht kërkesave të banorëve në vite dhe protestave të tyre, Bashkia Fier dhe UKF, nuk kishin ndërmarrë asnjë hap për furnizimin me ujë të pijshëm të këtyre banorëve.

3. Në kushtet që nga ana e Bashkisë Fier dhe UKF-së, nuk ishte dhënë një informacion i detajuar rreth investimeve që do të realizohen në këtë zonë apo që janë realizuar për furnizimin me ujë të pijshëm të lagjes Mbrostar, mbështetur në Urdhërin nr. 216, datë 06.11.2018, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë këtyre institucioneve më datë 09.11.2018, për të administruar informacionin⁵ e kërkuar për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës.

Fillimisht grupi i inspektimit mori takim me E. P., me detyrë Nënkyetare e Bashkisë Fier. Në vijim të inspektimit ndër të tjera E. P. sqaroi se: "...duke qënë se jëmi vënë me vonesë në dijeni të shkresës për inspektimin e sotëm, materiali i kërkuar nuk është përgatitur. Brenda datës 16.11.2018, do t'iu vëmë në dispozicion kopje të dokumentacionit dhe informacionin mbi investimet e kryera nga ana e Bashkisë Fier në ujësjellësat e ish-komunave apo në zonat ku banojnë komuniteti rom/egiptian."

Në zbatim të urdhërit të inspektimit, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a., ku morën takim me Drejtoren⁶ Teknik të këtij institucioni dhe Përgjegjësin⁷ e Repartit Nr. 2, i cili mbulon zonën e lagjes Mbrostar.

Ndër të tjera përfaqësuesit e UKF-së, theksuan faktin se: "Në zonën ku banojnë ankuesit ka qënë ekzistent rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm dhe aktualisht është dëmtuar nga vetë banorët e zonës. Në lagjen Mbrostar ka banorë edhe nga komuniteti i mazhorancës të cilët janë në të njëjtat kushte me ankuesit. Për shkak të dëmtimit të rrjetit të ujësjellësit, të gjitha familjet nuk furnizohen me ujë të pijshëm. Nëse banorët e kësaj zone do të bëjnë një kërkesë me shkrim pranë UKF-së dhe të lidhin kontratat përkatëse, do të furnizohen normalisht me ujë të pijshëm. Pra, çdo banorë pavarësisht përkatësisë etnike, nëse do të lidh konratën e Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Fier, do të furnizohet me ujë të pijshëm."

-
- ⁵Informacion mbi pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e shtetasve B. Z., A. Y., A. Sh. dhe K. Y.
 - Informacion dhe kopje të dokumentacionit provues nëse kryer ndonjëherë investime për furnizimin me ujë të pijshëm në lagjen Mbrostar, në zonën ku banojnë ankuesit.
 - Informacion nëse është parashikuar ndonjë projekt për furnizimin me ujë të pijshëm të lagjes Mbrostar, në zonën ku banojnë ankuesit. Nëse është hartuar ndonjë projekt apo janë miratuar fonde, kopje të tyre.
 - Informacion, nëse banorët e lagjes Mbrostar, i janë drejtar ndonjëherë Bashkisë Fier dhe UKF-së, lidhur me mungesën e ujit të pijshëm. Nëse po, kopje të tyre.
 - Marrja e çdo shpjegimi apo informacioni tjetër që nga palët do të gjykohet i arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

⁶ V. M.

⁷ E. E.

Në përfundim të inspektimit të kryer pranë UKF-së, përfaqësuesit e këtij institucioni theksuan se deri më datë 16.11.2018, do të vënë në dispozicion të KMD-së dokumentacionin e kërkuar mbi investimet që janë bërë gjatë 2 viteve të fundit në lagjet e qytetit të Fierit.

4. Në përgjigje të kërsave të bëra nga KMD gjatë procedurave të hetimit, Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a., me anë të shkresës⁸ Nr. 1006 prot., datë 15.11.2018 informoi Komisionerin lidhur me situatën e furnizimit me ujë të pijshëm të lagjes Mbrostar.

Ndër të tjera UKF sh.a., sqaroi se: “*Përpara 8 vjetësh ish-komuna Mbrostar, ka investuar në rrjetin e ujësjellësit në zonën ku banojnë ankuesit. Sot rrjeti i ujësjellësit është dëmtuar nga vetë banorët dhe aktualisht nuk kemi kryer investime në këtë zonë, sepse nuk kemi asnjë abonent nga ky komunitet që ka lidhur kontratë me UKF-në. Nëse ky komunitet lidh kontratat me ndërmarrjen UKF, atëherë ne jemi të gatshëm për të ndërrhyrë përfurnizimin me ujë për zonat përkatëse duke realizuar një projekt të mirëfilltë. Përsa i pëket pretendimit të ankuesve përfurnizimin përfshak të racës apo ngjyrës, nga ana e UKF-së, janë kryer investime edhe në lagje të tjera ku banojnë komunitet rom/egjiptian. Sqarojmë se komuniteti rom, veçanërisht në Levan është tepër problematik pasi shpërdorojnë ujin e pijshëm dhe janë debitorë. Shpërdorimi i ujit në këtë zonë sjell problematika në furnizimin me ujë të gjithë zonën e Njësisë Administrative Levan dhe Frakull e Madhe... ”.*

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, UKF vuri në dispozicion të KMD-së kopje të investimeve të kryera në disa zona të qytetit të Fierit, ku banojnë komunitet rom dhe egjiptian.

Në përgjigje të kërkeshave të KMD-së, me anë të shkresës⁹ Nr. 10817 prot., datë 21.11.2018, Bashkia Fier ka realizuar investime me kontrata sipërmarrje përfshak Komunitetin Rom dhe Egjiptian, me objekt: “

1. *Përmirësimi i kushteve të banimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian, përfshiu rikonstrukzionin e 15 banesave (fshati Baltëz), me vlerë 9,233,320 lekë. Investim i përfunduar.*
2. *Përmirësimi i kushteve të banimit të komunitetit Rom (faza II), përfshin gjithsej rikonstrukzionin e 40 banesave, përkatesisht 15 banesa në Njësinë Administrative Levan, 12 banesa në Njësinë Administrative Mbrostar dhe 13 banesa në Njësinë Administrative Topojë. Investimi është në fazë zbatimi, vlera e investimit 18,790,153 lekë.*
3. *Ndërtimi i miniparkut në lagjen Rome, me vlerë 508,058 lekë. Investim i përfunduar.”*

Gjithashtu, në këtë shkresë Bashkia Fier ka cituar investimet e realizuara nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike si:

⁸ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1558/2 prot., dt. 16.11.2018

⁹ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1660 prot., dt. 26.11.2018

1. Pastrime kanalesh dhe vendosje tombino Ø 500, Ø 800, gjithsej 39 copë, në fshatin Balltëz, në vitin 2017.
2. Pastrime kanalesh dhe vendosje tombino Ø 300, Ø 500, Ø 1500, gjithsej 46 copë, në fshatin Balltëz në vitin 2018.
3. Pastrime kanalesh dhe vendosje tombino Ø 500, gjithsej 26 copë, në Lagjen “1 Maji”, ku banojnë komunitet rom, në Levan.
4. Shtrim rruge me rërë bituminoze me sipërfaqje 2600 m², në Rrugën “Kumbrie Tahiri”, në lagje ku banon komuniteti rom në zonën e Azotikut, në vitin 2017.
5. Shtrim rruge me rërë bituminoze me sipërfaqje 1920 m², në Rrugën e lagjes “Romët”, në Drizë Myrteza, në vitin 2018.
6. Rikonstruksion i Shkollës “Trifon Prifti” në Hamil (riparim suvatime të brendshme, lyerje, mirëmbajtje tualetesh dhe riparim i murit rrethues) në vlerën 52.500 lekë.
7. Rikonstruksion i kopshtit të komunitetit Rom, në fshatin drizë Myrteza, në vlerën 70.406 lekë.

Në përfundim, Bashkia Fier nuk vuri në dispozicion të KMD-së, asnjë kopje të projekteve të hartuara për investime të kryera në zonat ku banojnë komuniteti rom dhe egjiptian, si dhe nuk vuri në dispozicion asnjë informacion rrëth furnizimit me ujë të pijshëm të zonës në të cilën banojnë ankuesit.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i administruar gjatë procedurave hetimore rezulton se, është fakt i provuar dhe i pranuar nga të dyja palët në proces që në këtë lagje ka mungesë të ujit të pijshëm prej disa vitesh dhe Bashkia Fier nuk ka dhënë asnjë informacion nëse në këtë zonë janë kryer apo mendohet të realizohen ndonjëherë investime në rrjetin e ujësjellësit. Banorët janë detyruar të sigurojnë ujin përmes shpimeve apo puseve në oborret e shtëpive të tyre.

Sipas informacionit të dhënë nga ankuesit, banorët e kësaj lagjeje, janë komunitet rom/egjiptian dhe jetojnë kryesisht me ndihmë ekonomike nga shteti dhe në kushte tërësisht të papërshtatshme jetese, si dhe me mungesë të ujit të pijshëm, gjë që çon në kushtet e trajtimit johuman të këtij komuniteti. Këta banorë kishin shprehur pakënaqësitë e tyre dhe kërkesën për pajisjen me ujë të

pijshëm prej vitesh, duke protestuar¹⁰ më datë 16.06.2017, përpara Bashkisë Fier lidhur me mungesën e ujit të pijshëm. Gjithashtu, referuar informacionit të dhënë nga pala ankuese, një grup prej 39 (tridhjetë e nëntë) personash nga komuniteti rom/egjiptian, banorë të Njësisë Administrative Mbrostar, më datë 24.12.2018, kanë paraqitur pranë Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a., një kërkesë¹¹ për furnizimin me ujë të pijshëm të këtyre familjeve.

Në pikën 2.3.2, të Vendimit Nr. 1304, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e modelit të Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizmet në zonën e shërbimit të Ujësjellës Kanalizmeve sh.a.”* parashikohet shprehimisht se: “*Për të përfituar të drejtën e pikës së lidhjes për furnizimin me ujë të pijshëm për një objekt, konsumatori kërkues duhet të paraqesë tek Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin (ZMK) në UK__ sh.a.:*

- *Kërkesë me shkrim në të cilën është përcaktuar sasia e ujit që kërkon (m3 në muaj ose 1/sek);*
- *Leja e ndërtimit,*
- *Akti i pronësisë së objektit,*
- *Planimetrinë e vendosjes së objektit*
- *Projekti hidraulik i sistemit të brendshëm të furnizimit me ujë, i cili realizohet nga persona ose subjekte të licensuara”.*

Në pikën 2.9.2, të Vendimit të sipërpërmendur parashikohet: “*Furnizimi me ujë të pijshëm nga UK__ sh.a. për konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë shtetërorë ose private, bëhet në bazë të kontratave të shitjes (furnizimit me ujë) që lidhen ndërmjet tyre.*”

Sikurse rezulton nga sa më sipër, furnizimi me ujë për konsumatorët familjarë bëhet pas paraqitjes së një kërkeze me shkrim dhe dokumentacionit të sipërcituar pranë ZMK-ve dhe në vijim, nëpërmjet lidhjes së një kontratë furnizimi me UKF sh.a.

Mos furnizimi me ujë të pijshëm i familjeve të kësaj zone deri në momentin që kanë paraqitur ankesë pranë KMD-së, ka ardhur si pasojë e mos ndjekjes së procedurave përkatëse prej tyre, lidhur me paraqitjen e kërkesës për furnizimin me ujë të pijshëm pranë ZMK-ve dhe lidhjen e kontratave të furnizimit me ujë. Nga ana tjetër edhe pas ankesës së bërë tek KMD dhe kërkesës pranë UKF-së më datë 24.12.2018, rezulton që banorëve nuk i është dhënë asnjë përgjigje dhe nuk është ndërmarrë asnjë masë për furnizimin me ujë të pijshëm si për çdo qytetar tjetër të këtij qyteti.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Fier. Pra, në këtë rast Bashkia, duhet të provonte se subjektet ankues nuk janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe më pak të favorshme se banorët e lagjeve të tjera jo rome.

¹⁰<https://www.youtube.com/watch?v=iM3Y4y74Rfk>, dt 16.06.2017

¹¹ Kërkesa mban datën 16.12.2018 dhe është protokolluar pranë UK Fier me Nr. 1078, datë 24.12.2018.

Kështu, nen 82, pika 2 e tij, përcakton se: “*Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

Në këto kushte, referuar informacionit të administruar, Bashkia Fier dhe UKF sh.a., nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion zyrtar, projekt apo plan, mbi masat që ka marrë ose që do të ndërmarrë për furnizimin me ujë të pijshëm të lagjes “Mbrostar”, ku banojnë ankuesit.

Institucioni i Bashkisë Fier dhe UKF sh.a., dështuan të provonin para Komisionerit se kanë bërë përpjekjet e duhura dhe të domosdoshme për rregullimin e kësaj situate, pasi edhe pse nga ana e banorëve të kësaj zone është depozituar kërkesa furnizimin me ujë të pijshëm, nga na e këtyre institucioneve nuk u është siguruar furnizimi me ujë të pijshëm.

Në analizë të sa mësipër, mungesa e ujit të pijshëm, është fakt i njohur prej kohësh, për të cilat Bashkia Fier dhe UKF sha., nuk kanë marrë asnjë masë për t'i dhënë zgjidhje kësaj situate. Mospërbushja e detyrimeve të sanksionuara në legjispcionin shqiptar, nga ana e Bashkisë Fier dhe UKF sh.a., vendos në pozita të pabarabarta ankuesit me banorë të tjerë të Bashkisë Fier të cilët furnizohen me ujë të pijshëm dhe brenda standardeve, duke dështuar në marrjen e masave të duhura për përmirësimin e kushteve të jetesës.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin ¹² të ligjit Nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

¹² Neni 2: “*Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.*”

Ankuesit pretendojnë se janë trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë, nga ana e Bashkisë Fier dhe UKF-së për shkak të *racës, etnisë dhe gjendjes ekonomike*, shkaqe të cilat janë parashikuar në nenin 1 të Ligjit Nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”.

Gjatë trajtimit të ankesës, u administruan prova dhe argumenta se ankuesit disponojnë shkakun e mbrojtur të racës dhe etnisë¹³. Sa i përket shkakut të gjendjes ekonomike, nga ana e ankuesve nuk u vunë në dispozicion argumenta dhe fakte, se trajtimi i pafavorshëm ka ardhur si rezultat i këtij shkaku.

“Raca dhe etnia” janë shkaqe, për të cilat Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzinanë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Shkaqet e origjinës sociale, lindjes dhe pronës paraqiten në Nenin 2(2) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e vitit 1966. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, përgjegjës për monitorimin dhe interpretimin e traktatit e ka zgjeruar kuptimin e tyre në Komentin e tij të Përgjithshëm 20. Sipas Komitetit, statuset e “origjinës sociale”, “lindjes” dhe “pronës” janë të lidhura. Origjina sociale “tregon statusin social të trashëguar të individit”. Mund të lidhet me pozitën që kanë përfituar me lindjen në një komunitet ose klasë shoqërore të caktuar (si p.sh. përkatësia etnike, besimi fetar, ose ideologjia), ose nga situata shoqërore si p.sh. varfëria ose të qenurit i pastrehë. Shkaku i pronës mund të lidhet me statusin e dikujt në lidhje me tokën (si të qenit një qiramarrës, pronar ose banues i paligjshëm), ose në lidhje me pronën e të tjerve.¹⁴

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Fier dhe UKF-së, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkaqeve të pretenduara nga ankuesit,

¹³ Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “*Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupei personash*”.

¹⁴ Marrë në https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_law_ENG.pdf

sipas parashikimeve të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹⁵ dhe trajtimit të pafavorshëm të saj.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Fier dhe UKF¹⁶, ishin në dijeni të problematikave të ngritura nga ankuesit dhe se kishin dështuar deri më tanë të ndërmerrnin masa për përmirësimin apo rregullimin e situatës.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta¹⁷ si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Dinjiteti i njeriut është një vlerë themelore kushtetuese¹⁸. Një shoqëri demokratike, që bazohet në dinjitetin e njeriut dhe parimin e barazisë së gjëzimit të të drejtave themelore nga të gjithë individët, duhet të garantojë plotësimin e nevojave bazike jetësore për të gjithë. Çdo individ është pjesë e një komuniteti shoqëror të caktuar dhe në këtë kontekst interpretohet edhe dinjiteti i njeriut, si një garanci themelore.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive

¹⁵ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionë gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

¹⁶ Referuar shkresës me nr. 1558/2 prot., datë 15.11.2018 të UKF-së dhe nr. 10817 prot., datë 21.11.2018 të Bashkisë Fier drejtuar Komisionerit.

¹⁷ Neni 18 i Kushtetutës ka sanksionuar se: “Të gjithë janë të barabartë përpëra ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tillë si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”.

¹⁸ Në Preambulën e Kushtetutës deklarohet: “Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë”.

themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij.

Neni 14, i KEDNJ, “Ndalimi i diskriminimit”, përcakton se: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnje dallim të bazuar në shkaqe të tillë si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”.

Në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë¹⁹, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: “*...kemi një diskriminim kur shteti pa një argumentim objektiv dhe racional e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata e të cilëve është tepër e ndryshme...*”.

Në interpretim të çështjes së sipërcituar, GJEDNJ përcakton se Konventa Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila është pjesë e legjislacionit të brendshëm²⁰ dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në mbrojtjen nga diskriminimi përfshin jo vetëm detyrimin e trajtimit të barabartë të personave në situata të njëjtë, por dhe trajtimin ndryshtë të personave në situata të ndryshme.

GJEDNJ-ja në disa raste ka konkluduar se kushtet e mjerueshme të jetesës mund të konsiderohen si trajtim çnjerëzor dhe degradues²¹. Gjykata është shprehur se mungesa e aksesit për ujë të pijshëm dhe higjenë çon në trajtim çnjerëzor dhe degradues të njeriut.

Referuar rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 64/292, datë 28 korrik 2010, në të cilën Asambleja njohu të drejtën për ujë të pijshëm të pastër dhe të sigurt si një të drejtë të njeriut, e cila është thelbësore për gjëzimin e plotë të jetës dhe të gjitha të drejtave të njeriut, theksohet se uji i pastër është esencial në realizimin e të gjitha të drejtave të njeriut. Kjo rezolutë shton trysninë mbi përgjegjësinë politike të shteteve për t'u garantuar qytetarëve të drejtën elementare për ujë të pijshëm.

Në këtë këndvështrim, mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm apo lejimi i përdorimit të puseve të pakontrolluara për të siguruuar mbulimin e nevojave minimale për ujë, nga ana e Bashkisë Fier dhe UKF-së, u ka rrezikuar shëndetin këtyre banorëve dhe i ka vënë në kushtet e një trajtimi të papërshtatshëm dhe degradues. Vazhdimi i kësaj situate për vite me radhë pa ndërmarrë asnje

¹⁹Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000.

²⁰Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, hyrë në fuqi në datë 02.08.1996) dhe jurisprudanca e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar bazuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

²¹ Çështja “Neshkov dhe të tjera kundër Bullgarisë” dhe “Jordan Petrov kundër Bullgarisë” dhe “Halil Adem kundër Bullgarisë”.

Adresa: Rruga “Durrësit” (ish godina e Ministrisë së Mjedisit), Tiranë , Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

masë rregulluese, provon se Bashkia Fier dhe UKF përmes mosveprimit, kanë neglizhuar të përbushin detyrimet ligjore që parashikojnë aktet përkatëse.

Referuar nenit 23, pikat 1 dhe 2, të ligjit Nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, ku përcaktohen funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, vërejmë se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksonit të tyre për: prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, si dhe mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Referuar nenit 23, pika 4, të ligjit Nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, ku përcaktohen funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, vërejmë se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksonit të tyre për prodhimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjet në zonat e banuara.

Nuk mund të pretendohet se është përbushur detyrimi ligjor për furnizimin me ujë të pijshëm vetëm përfshin faktin se ekziston rrjeti fizik i dëmtuar i linjave të ujit. Furnizimi me ujë nuk përfshin vetëm ekzistencën e rrjetit fizik të furnizimit me ujë, por aksesin e qytetarëve në ujin e pijshëm; në mënyrë të mjaftueshme dhe të vazhdueshme, si përdorimin personal, ashtu edhe për atë shtëpiak. Pikërisht fakti i ekzistencës së linjave të ujit të pijshëm në lagjen Mbrostar ku banojnë ankuesit dhe mosfurnizimi në mënyrë efektive me ujë të pijshëm ka përballur ata dhe komunitetin që banon në këtë zonë me një trajim të pafavorshëm në raport me qytetarët e tjerë të Bashkisë Fier.

Kuadri ligjor ka mirëpërcaktuar se është detyrë e përgjegjësi e UK-së (që është në varësi të pushtetit vendor) të sigurojë furnizimin me ujë të pijshëm dhe të shëndetshëm. UK ka detyrim të shtrojë linjat e furnizimit, të vendosë matës në familjet konsumatore dhe të bëjë furnizimin me ujë të pijshëm.

Lidhur me sa mësipër, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore i KB (CESCR), kërkon që shtetet të angazhohen për ngritjen e sistemeve për shpërndarjen e ujit, që shmangin përashtimin e grupeve të caktuara të popullsisë, e veçanërisht ato grupe të mbrojtura nga parimet e mosdiskriminimit.

Sipas CESCR-së: “*Shtetet palë duhet të ndërmarrin hapa për të eliminuar “de facto” diskriminimin për shkaqet e ndaluara në ligj, ku individët apo grupet e personave nuk duhet të jenë të privuara nga mjetet apo të drejtat për të siguruar të drejtën e ujit. Shtetet palë duhet të sigurojnë që, shpërndarja e burimeve të ujit dhe investimet për ujin të lehtësojnë aksesin tek uji për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Duke respektuar të drejtën për ujë, Shtetet palë kanë detyrimin*

e posaçëm për t'u sigruuar atyre që nuk kanë, ujin e pijshëm si dhe për të parandaluar çdo diskriminim për shkaqet e ndaluara dhe të njohura në të drejtën ndërkombëtare lidhur me sigurimin e ujit të pijshëm dhe të shërbimeve të ujit”.

Lidhur me sa mësipër, si dhe nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës dhe shpjegimet e dhëna nga palët, provohet fakti që ka patur një trajtim të diferencuar dhe të pafavorshëm të ankuesve dhe banorëve të lagjes Mbrostar, krahasuar me banorët e tjera të Bashkisë Fier, të cilët furnizohen normalisht dhe brenda standardeve, me ujë të pijshëm.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, mosveprimet nga ana e Strukturave të Bashkisë Fier dhe UKF-së, në dëm të ankuesve dhe banorëve të lagjes Mbrostar, kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tyre në kushte të disfavorshme, pa shkaqe të arsyeshme, duke i vënë në pozita diskriminuese për shkak të racës, etnisë dhe gjendjes së tyre sociale.

Neni 3 i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka përcaktuar se: ““Diskriminim i drejtëpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjeter, apo një grup personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilind shkak të përmendur në nenin I të këtij ligji”.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1²², të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se ankuesit, janë eksposuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e Strukturave të Bashkisë Fier dhe UKF-së, trajtim i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë, me gjendjen sociale të tyre.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 12, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërmë a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, etnisë dhe gjendjes sociale, të shtetasve A. Y., A. Sh. dhe K. Y. dhe të banorëve të lagjes “Mbrostar”, nga ana e Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime sh.a.

²²Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupei personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrëthana të njëjtë ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjera ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme për rregullimin e problematikës së këtyre banorëve nga ana e Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime sh.a.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Bashkia Fier dhe Shoqëria Ujësjellës Kanalizime sh.a., të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij nenit.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Raca, etnia dhe gjendja sociale)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)